

**Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare - Konferencë Kombëtare**  
**“SFIDAT E ZHVILLIMIT TË TREGJEVE NËN MBIKËQYRJEN**  
**E AMF-SË DHE EDUKIMI FINANCIAR”**  
**24 Maj 2018 - Tiranë, Shqipëri**

**FAKTORËT QË NDIKOJNË NË FUNKSIONIMIN E BURSËS**

**Ardita Ndoj<sup>1</sup>**  
**Fatjon Lila<sup>2</sup>**  
**Marvin Lila<sup>3</sup>**

***Abstrakt***

Në realitetin e sotëm, njësitë ekonomike e deri shtetet po konkurrojnë vazhdimisht drejt arritjes së niveleve sa më të larta të zhvillimit ekonomik dhe inovacionit. Në arritjen e këtyre qëllimeve, këta aktorë mbështeten në një sërë tregjesh, një prej të cilëve është tregu i kapitaleve financiare.

Qëllimi i këtij punimi është të evidentojë faktorët që ndikojnë në funksionimin e bursës si treg titujsh, shkallën e prezencës së tyre në Bursën e Shqipërisë si dhe të parashikojë ndikimin e bursës më tej në ekonominë tonë. Tema e përzgjedhur gjendet brenda kuadrit të tregut të kapitalit dhe fondeve të investimeve.

Fokusi i studimit tonë mbetet bursa, një treg i ri në Shqipëri që përballlet me sfida, problematika në të cilat lipset të rritet edukimi qytetar. Në kuadër të realizimit të këtij studimi janë përdorur qasje përshkruese (historike), analizuese dhe statistika përshkruese. Një pjesë e punimit i kushtohet anketimit dhe vlerësimit të një numri biznesesh shqiptare rreth qëndrimit të tyre në lidhje me bursën dhe plotësimin të kriterëve për t'u anëtarësuar në të.

Rezultatet nxjerrin nevojën e tregut shqiptar për një bursë mirëfunktionale, sfidat, si dhe përfitimet që pritet të sjellë pjesëmarrja më e lartë në këtë treg veçanërisht e bizneseve.

***Fjalë kyçe:*** bursa, faktor, ekonomi, ndikim.

---

<sup>1</sup> Universiteti Aleksandër Moisiu, Durrës

<sup>2</sup> Universiteti Aleksandër Moisiu, Durrës, fatjonlila97@gmail.com

<sup>3</sup> Universiteti Aleksandër Moisiu, Durrës